



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B/22

Data: 20/04/2021

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), bazuar në nenin 8 paragrafi 6 nënparagrafi 6.3 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17, 16 shtator 2011), neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4, shtojca 1 paragrafi 7 i Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 30. 03. 2021, Udhëzimit administrativ nr. 08/2012, dt. 23.05.2012 për dokumentacionin shkollor parauniversitar, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për organizimin e mësimit plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve si pasojë e pandemisë COVID-19

1. Organizimi i mësimit plotësues do të implementohet në nivelin (I, II dhe III) të arsimit parauniversitar.
2. Për nxënësit e nivelit të arsimit fillor (I-V), mësimi plotësues do të organizohet në lëndët gjuhë amtare dhe matematikë.
3. Për nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët (VI-IX) dhe të nivelit të arsimit të mesëm të lartë (X-XII), mësimi plotësues do të organizohet në lëndët gjuhë amtare, matematikë dhe në shkencat natyrore.



4. Organizimi dhe zhvillimi i mësimit, duhet të realizohet në shkollë në përputhje me rekomandimet e institucioneve përgjegjëse (IKSHPK, MSH), për mbrojtjen nga pandemia COVID-19.
5. Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), deri më datë 28 prill 2021, duhet të dorëzojnë në Inspektoratin e arsimit (MASHTI), planifikimet e shkollave për organizimin dhe zhvillimin e mësimit plotësues.
6. Organizimi dhe mbajtja e mësimit plotësues në institucionet arsimore, fillon nga data 03 maj 2021 dhe vazhdon deri në përfundim të vitit mësimor 2020-2021.
7. Drejtoritë Komunale të Arsimit, duhet të raportojnë 2 herë brenda muajit në Inspektoratin e arsimit (MASHTI), për organizimin dhe mbarëvajtjen e ecurisë të mësimit plotësues në shkolla.
8. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Përhapja e pandemisë COVID-19, ka paraqitur vështirësi të mëdha në shumë dimensione edhe në vendin tonë dhe në veçanti kjo situatë ka reflektuar edhe në procesin edukativo-arsimor. Si rezultat i kësaj situatë të krijuar, organizimi i procesit mësimor për vitin shkollor 2020-2021, është duke u zhvilluar sipas skenarëve A, B dhe C të përcaktuar sipas udhëzuesit të përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet dhe rrethanat e krijuara nga pandemia COVID 19. Mbase një numër i konsiderueshëm i nxënësve nuk kanë arritur të përcjellin mësimin dhe të arrijnë të përmbushin rezultatet e të nxënësve të parapara me programet mësimore-lëndore, si pasojë e mungesës së pajisjeve dhe qasjes në internet etj.

Pandemia COVID-19, ka ndikuar dhe rezultuar në humbjen e orëve mësimore në nivelin e arsimit parauniversitar në të gjithë vendin dhe në veçanti duke thëlluar edhe më tej edhe më pabarazinë në mes fëmijëve-nxënësve. Përballë qasjes së pabarabartë në të mësuar në distancë dhe kohës së zvogëluar të mësimdhënies, nxënësve që vijnë nga familjet me të ardhura të ulëta, nxënësve të komuniteteve dhe ata me nevoja të veçanta janë në rrezik të veçantë të mbesin pas.

Andaj, nga vlerësimi i gjendjes, konstatohet se mësimi plotësues është një prej mundësive që do të lehtësojë humbjen e mësimit, përsheptimin e të nxënësve dhe përmirësimin e arritjeve të rezultateve të nxënësve.

Vendimi i dorëzohet:

1. Drejtorive Komunale të Arsimit;
2. Kabinetit të Ministrisë / MASHTI;
3. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm / MASHTI;
4. Departamentit të arsimit parauniversitar / MASHTI;
5. Inspektoratit të arsimit;
6. Arkivit /MASHTI.

Arbërie Nagavci

Ministre e MASHTI

